



Primanje / Dostizanje Prijem / Pristup Received / Delivery	18.01.2023	viti god. year	3
Organ / Ustava Organ / Ustava Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	487/2023		1/2



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1298/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1298/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "Kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 18.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1298/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 28.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8523 të regjistruar nën shenjen A.nr.1298/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën e punës Sekretar (9 - pozita) në Institucionet Edukativo - arsimor të Komunës së Prizrenit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh faktin se objekt i kësaj çështje ankimore është procedura e rekrutimit për pozitën e punës Sekretar në Institucionet Edukativo - arsimor, konstatoi se Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse:

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 përcaktohet se 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës

shitetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, nga rrjedh se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Edukativo arsimore e kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publikë.

Andaj, duke marr parasysh faktin se ankuesi ka aplikuar për pranim në pozitë të Shërbimit Publikë, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, dhe si rrjedhojë as të kandidatit për pranim në Shërbimin Civil dhe për pasojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1298/2022 të datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesi . ngase bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Këshilli shqyrton dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të Shërbimit Publikë, ashtu sikurse edhe kandidatet për pranim në pozitë me status të Shërbimit Publikë, siç është rasti i ankuesit, kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente, kështu që Kolegji i Këshillit udhëzon palën ankuese për ushtrimin e ankesës fillimisht të punëdhënësi, gjegjësisht në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në Komuna e Prizrenit dhe më pas i njëjti mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.


Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1298/2022

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

